

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: Komuna e Prishtinës	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP 488/18 dhe 694/18 Urdhëresë me nr,83/19
	OE-të ankuese NNT Eing Com -Podujevë		
Prej:	Teuta Krasniqi  Eksperte profesionale e prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr.274/19 të parashtruar nga OE "NNT Eing Com –Podujevë"		
Datë	19.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, ju njoftojmë me raportin e ekspertit, lidhur me ankesën e dt: 03.06.2019 me nr. 274/19 të parashtruar nga OE "NNT Eing Com -Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi i shportave të xhepit dhe ulseve" me nr. të prokurimit 616-18-5173-121 , iniciuar nga

autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi i Komunes së Prishtinës

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.


Ti dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - Kuvendi i Komunes së Prishtinës
Panelit Shqyrtues - OSHP
OE ankues: OE "NNT Eing Com-Podujevë"



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTII EKSPEERTIT SHQYRTUES

 Nënshkrimi i ekspertit	06.06.2019 Data e autorizimit të ekspertit.	08.06.2019 data e (pranimi) fillimit të ekspertizës	19.06.2019 data e dorëzimit të raportit
---	--	--	--

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyriim

Me datën: 03.06.2019, OE ankues: OE”NNT Eing Com -Podujevë , ka parashtruar ankesë në OSHP me nr 274/19 , kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit ,lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi i shportave të xhepit dhe ulseve ”me nr. të prokurimit 616-18-5173-121 , iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi i Komunes së Prishtinës.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit kemi pas një Ankesë nga OE”NNT Eing Com -Podujevë ,kjo ankes është parashtruar pas njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit (Ankesë kundër njoftimit për anulim të kontratës)lidhur me këtë qështje OSHP.ja nxjerr dy vendim me nr. 488/18 dhe vendimin 694/18 po ashtu OSHP nxerr edhe një Urdhëresë Për Komunen e Prishtinës.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Ekspertja Shqyrtuese i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues: "OE"NNT Eing Com" -Podujevë

Ne me date 21.05.2019, kemiparashtruar kërkesëpër rishqyrtim pranë AK KK Prishtines për aktivitetin e prokurimit nefjale, me date 23.05.2019, na kane refuzuar kërkesën për rishqyrtim, tani duke u arsyetuar se zyrtari kryesor administrativ dhe Zyrtari përgjegjës per financa jane deklaruar se nuk e rikonfirmojne disponueshmerine e mjeteve për realizimin te këtij aktiviteti dhe kjo nënkupton se momentalisht nuk mund te vazhdohet aktiviteti. Mbetet ne fuqi vendimi paraprak për anulimin e aktivitetit.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues:" OE"NNT Eing Com -, janë shkelur:

- Neni 7 i LPP-se nr.04/L-042-Barazia neTrajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 41 i Rregullave dhe UOPP-se-Egzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 28 i Rregullave dhe UOPP-se-Kriteret e dhënjes së kontratës.
- Neni 59 i LPP-se nr.04/L-042- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 69 i LPP-se nr.04/L-042-Aftesia Teknike dhe/ose Profesionale

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET

Ne me date 15.05.2019 kemi pranuar një email ku thuhet se:

I nderuar ,

Ju njoftoj se Departamenti I Prokurimit ka kryer obligimet e veta duke rivlerësuar tenderin dhe duke propozuar lenderin tuaj per dhënje te kontratës. Poashtu bazuar ne nenin 8.7 te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ per Prokurim Publik, zyrtari përgjegjës i prokurimit ka aprovuar edhe Deklaratën e nevojave dhe përcaktimit te disponueshmërise se fondeve, por Zyrtari Kryesor Administrativ-Kryetari I Komunës ka vendosur qe te mos e aprovoj- nënshkruar te njëjtin me arsyetimin se si rezultat I sterzgjatjës se aktivitetit kane ndryshuar rrethanat ,kushtet dhe aspekti jinanciar lidhur me këtë aktivitet .Bazuar ne këtë ju njoftojmë se mosaprovimi I Deklaralës se nevojave dhe përcaktimit te disponueshmerise se fondeve na pamundëson qe te vazhdojmë me tutje me këtë aktivitet.

AK nuk ka dërguar letër standarde për anulimin e aktivitetit siç parashihet me ligj, e as nuk e kane publikuar ne platformën e e-prokurimit, vetëm na kane dërguar nje email i cili thuhet qe nuk mund te vazhdojmë me kete aktivitet te prokurimit pershkak disponueshmerise se mjeteve.

AK Komuna e Prishtinës edhe për të pestën herë tenton ta anulojë aktivitetin e prokurimit kundërligjshëm, edhe pse ekzistojnë 3 vendime të OSHP-se.

Kërkojmë nga OSHP që ta urdhërojë AK Komuna e Prishtinës, që të vazhdojë me procedurë sepse nuk ka kurrfarë kuptimi tani mu arsyetë se zyrtari kryesor financiar nuk e nënshkruan disponueshmërinë e mjeteve, pasi që me rastin e hapjes së procedurës për një aktivitet të prokurimit disponueshmëria e mjeteve duhet të nënshkruhet dhe ka qenë aty

Tani pas 3 vendimeve të OSHP-se janë bindur se ne jemi OE i përgjegjshëm, tani gjejmë metoda tjera për të mos e respektuar vendimin e OSHP-se.

Kjo është tendencioze dhe e qëllimshme nga ana e AK komuna e Prishtinës.

Kërkojmë nga OSHP që ankesën tonë ta aprovojë tonë si të bazuar dhe lenden ta kthejë në rivlerësim, si dhe ta urdhërojë AK komuna e Prishtinës që ta zbatojë vendimin 488/18, dhe 694/18, si dhe urdhëresën 83/19 të datës 12.04.2019

Dëshmi 3: Urdhëresa 83/19 e datës 12.04.2019

9. Dëmet materiale

Përkrahur mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet të 'i shkaktojë dëm materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim

Kriteret për vlerësim:

III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

Kërkesat:

1) Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 \ L-42. LPP mund të shkarkohet nga <http://krpp.rksgov.net>

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1) Deklaratën nën betim, origjinal, se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04/L-042, Neni 65, kërkohet origjinali- Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit

2). Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit .- kërkohet origjinali ose kopja vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërbllim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit për Dhënie të Kontratës.

3). Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata – kërkohet origjinali ose kopja vetëm nga Operatorin Ekonomik që propozohet për shpërbllim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit për Dhënie të Kontratës.

Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontrate të sjelle dokumentet të kërkuara në pikën 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, dhe të vazhdojë me shpërbllim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është rendit në vendin e dytë e kështu me radhe.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

- a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit (kopje).

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

a) Operatori Ekonomik duhet që të ketë kryer kontratë të ngjajshme gjatë tri viteve të fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë në vlerë totale prej 50,000 Euro.

- b) OE Duhet të dorëzojë katalogun për shportat e ofruara .

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a) Lista e projekteve të realizuara në tre vitet e fundit për kontratat e realizuara dëshmuar me kopjet e referencave apo certifikatat e pranimeve

- b) Kopja e katalogut

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.4) Siguria e tenderit

-Sigurimi i tenderit 1,000.00 €

Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 90

IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit 60 ditë

Procesi i prokurimit

Data e publikimit të njoftimit për kontratë.....	13.07.2018
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar :Kontratë publike	Sherbim/e mesme
Vlera e parashikuar e kontratës:.....	50.000,00 €
Kriteri për dhënie të kontratës... tenderi i përgjegjshëm me çmim më të lirë	(Çmimi total i peshuar)
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....	09.08.2018 ora 13:30
Data e hapjes së ofertave	09.08 .2018,ora 13:30
Data e njoftimit për anulim	03.09.2018
Data e kërkesës për rishqyrtim	07.09. 2018
Data e vendimit të AK-se	07.09.2018
Data e parashtrimit të ankesës në OSHP.	14.10.2018
Data e vendimit të OSHP-se.....	24.10.2018
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues e eleminuar	14.11.2018
Data e anulimit të aktivitetit të prokurimit	14.11.2018
Data e kërkesës për rishqyrtim	16.11. 2018
Data e vendimit të AK-se	19.11.2018
Data e parashtrimit të ankesës pran OSHP-se	29.11.2018
Data e vendimit të OSHP-se.....	08.01.2019
Data e anulimit të aktivitetit të prokurimit	06.02.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim	11.02.2019
Data e vendimit të AK-se	13.02.2019
Data e anulimit të aktivitetit të prokurimit	16.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim	21.05.2019
Data e vendimit të AK-se	23.05.2019

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi me TVSh	Vërejtje
1.	"N.N."EING COM"	Podujev	239.25	Jo
2	N.T.P."DAQA"	Ferizaj	328.65	Jo

Komisioni i Rvlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit-vlerësues.

Autoritetit Kontraktues ka caktuar përbërjen e komisionit për vlerësimin e tenderëve, të njëjtit kanë plotësuar dhe nënshkruar Deklaratat nënë Betim, dhe kanë nxjerr Raport të vlerësimit .

Komisioni në përbërje prej 3 anëtarëve si në vijim:

1. Hateme Gashi -Kryesuesi i komisionit
2. Xhemshit Gashi -Anëtare e komisionit
3. Seniha Bajraktari -Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit Rivlerësues:

Sipas raportit të komisionit të rivlerësimit ofertat të PËRGJEGJSHME nuk ka :

Komisioni i Ri-vlerësimit konstaton se OE Eing Com shpk. plotëson te gjitha kushtet e përcaktuara në dosjen e tenderit në lidhje me kërkesat e përzgjedhjes,ndërsa përsa i përket çmimit të ofruar edhe pse vlerëson se çmimi i ofruar për "Furnizimi me material dhe punimi i themelit nga betoni " në vler prej 495 E është shumë i lartë në krahasim me çmimin e tregut. Kjo mundë të vërtetohet dhe nga oferta e OE-të cilat janë kërkuar me qëllim të hulumtimit të çmimit të tregut ,mirpo Auteriteti Kontraktues obligohet që vendos në bazë të URDHERESES së OSHP-së me nr 83/19 të datës 12.04.19 dhe si rrjedhojë e propozon për shpërbllim të kontratës OE Eing Com.

Ofertat e përgjegjshëm që nuk i kanë plotësuar kërkesat sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit

N.N."EING COM" Podujevë

Nr	Përshkrimi i punëve Shpimi i puseve	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total i
1.	Furnizim me shporta 90 l sipas specifikimit teknik Aneks 1 ne dosjen e tenderit	Copë	1	220 .00	204.60
2	Përshkrimi i punëve Pershkrimi i pompes dhe materialit elektrik	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total i peshuar 7
	Furnizim me material dhe punimi i themelit nga betoni sipas specifikimit teknik Aneks 1 ne Dosjen e tenderit	Copë	1	495.00	34.65
Totali				715.00	239.25
Çmimi i pergjitheshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen ne bazë të kësaj vlere) Kjo është vlera e cila do duhej të shënohet në Formularin e ofertës dhe do të lexohet gjatë hapjes publike -G9					

N.T.P."DAQA" Ferizaj

Nr	Përshkrimi i punëve Shpimi i puseve	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total i peshuar
1.	Furnizim me shporta 90 l sipas specifikimit teknik Aneks 1 ne dosjen e tenderit	Copë	1	350 .00	325.50
2	Përshkrimi i punëve Pershkrimi i pompes dhe materialit elektrik	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total i peshuar 7 %
	Furnizim me material dhe punimi i themelit nga betoni sipas specifikimit teknik Aneks 1 ne Dosjen e tenderit	Copë	1	45.00	3.15
Totali				395.00	328.65
Çmimi i pergjitheshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen ne bazë të kësaj vlere) Kjo është vlera e cila do duhej të shënohet në Formularin e ofertës dhe do të lexohet gjatë hapjes publike -G9					

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "N.N." EING COM"-Podujeva

Duke u mbështetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit , konstatojmë me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimet nr.1,2,3,4,5.

OE ankuese "N.N."EING COM"-Podujevë , pretendon se AK-së Komuna e Prishtinës nuk i ka respektuarë

këto nene :

Nenin 7 të LPP-së,

Neni 59 i LPP-së nr.04/L-042- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve,

Neni 69 i LPP-se nr.04/L-042-Aftësia Teknike dhe/ose profesionale

Nenin 41 i Rregullave dhe RRUOPP-ik -Egzaminimi, vlerësimi dhe krahësimi i tenderëve ,

Neni 28 i Rregullave dhe RRUOPP-se-Kriteret e dhënjes së kontratës .

Ekspertja konstaton se të gjitha këto pretendime janë shqyrtuar nga Paneli shqyrtues i OSHP-së dhe të njëjtat konsiderohen „qështje të Gjykuara”

Sepse kemi dy (2) vendime nga OSHP-ja dhe një Urdhëresë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së .

Vendimi i OSHP-së përkatësisht i Panelit Shqyrtues nr, 488/18,të datës 24.10.2018 ,

Vendimi i OSHP-së përkatësisht i Panelit Shqyrtues nr.694/19 i datës 08.01.2019 dhe kemi ,

Urdhëresë nga OSHP-së përkatësisht nga Panelit Shqyrtues nr: 83/19 të datës 12.04.2019.

Lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi i shportave të xhepit dhe ulëseve” me nr. të prokurimit 616-18-5173-121 “

Andaj bazuar në këto vendime dhe në urdhëresë konsideroj se këto pretendime janë „qështje të Gjykuara”

Përgjigje në Pretendimin nr.6

Sa i përket pretendimit të OE.ankuesë, se AK.së nuk ka dërguar Letër Standarde për anulimin e aktivitetit siç parashihet me ligj, e as nuk e kanë publikuar ne platformën e e-prokurimit, vetëm na kane dërguar një email në të cili thuhet qe nuk mund te vazhdojmë me këtë aktivitet te prokurimit për shkak disponueshmëris se mjeteve.

Ekspertja mendon se pretendimi është pjesërisht bazuarë sepse në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë Letër Standarde edhe në E-prokurim nuk ka Letër Standarde mirëpo egziston Njoftimi mbi Vendimi e AK-së të cilit i është bashkangjitur edhe Emaili i Kryetarit të Komunës z.Shpend Ahmeti me të cilin email informon se nuk e nënshkruan Deklaratën e Nevojave dhe Disponueshmerin e fondeve.

Edhe emaili dërguar OE .ankues në të cilin thuhet qe nuk mund te vazhdojmë me këtë aktivitet te prokurimit për shkak disponueshmërisë se mjeteve. Konsideroj se është i mjaftueshëm për informim.

Ekspertja konstaton se pretendimi është pjesërisht i bazuarë.

Përgjigje në Pretendimin nr.7

Sa i përket pretendimit të OE.ankuesë, se nuk ka kurfar kuptimi me u arsyetua se zyrtari kryesor financiar nuk e nënshkruan disponueshmërisë e mjeteve pasi që me rastin e hapjes së procedurës për një aktivitet të prokurimit duhet të nënshkruhet dhe ka qenë aty (DNPDF)dhe se kjo është e qëllimshme dhe tendencioze nga ana e AK-së Komuna e Prishtinës.

Pretendimi është i pa qëndrueshëm sepse në bazë të Nenit 9 të LPP-së dhe paragrafit 8.7 të RRUOPP -Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve ,Personat që kanë autoritet të nënshkruajnë kontratë janë të obliguar, para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës ,të rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar në mënyrë substanciale .

Pretendimi pjesërisht i pranueshëm sepse AK-së nuk ka dëshmuar me ndonjë dokument -vendim se si kanë ndryshuar gjendja financiare e cila ka qen e planifikuar për këtë aktivitet të prokurimit .

Andaj Ekspertja konstaton se pretendimi është pjesërisht i bazuarë.

Mendimi nga Ekspertja e Prokurimit

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesën e Operatorit Ekonomik „NNT Eing Com” ta aprovoj si pjesërisht të bazuarë dhe të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Rivlerësim**.